

	Politika E Paanshmërisë	PO 02
		Data 10.10.2016
Rr. Dibrës, Kompleksi Halili, 1017, Tiranë	Versioni 1	

## POLITIKA E PAANSHMËRISË

Organizmi Austrian Institute of Excellence është i paanshëm, i lirë nga çdo ndikim nga kushdo që ka interes tregëtar apo financiar në procesin e çertifikimit.

Organizmi Austrian Institute of Excellence, ndjekë procedurat e çertifikimit në mënyrë jo diskriminuese.

Klientët/subjektet vendosen në kushte të barabarta pavarësisht nga madhësia, numri i shërbimeve që kërkojnë të çertifikojnë, nëse janë individë apo subjekte, shtetëror apo privat.

Organizmi ka një personel me përvojë në fushën e sigurisë elektrike dhe standardin ISO/IEC 17024 dhe implementimin e sistemit të cilësisë.

Organizmi ka hartuar dhe zbaton procedura dhe politika, të cilat garantojnë paanshmëri dhe barazi në procesin e çertifikimit për të gjithë klientët tanë.

Personeli i Organizmit Austrian Institute of Excellence ka nënshkruar deklaratat paanshmërisë dhe ruajtjes së konfidencialitetit. Këtë deklaratë do ta firmosin gjithë personat e përfshirë në procesin e çertifikimit, apo dhe nënkontraktorët.

Personeli i Austrian Institute of Excellence, i përfshirë në procedurat e çertifikimit nuk duhet të kenë interesa financiare, tregtare, miqësore, lidhje gjaku që mund të influencojnë në procesin e çertifikimit.

Të gjitha palët e interesuara të cilat përfshihen në zhvillimin dhe përmirësimin e politikave dhe parimeve në lidhje me akreditimin nuk duhet të kenë konflikt interesash me procesin e çertifikimit

Në rastet e shfaqjes së konfliktit të interesit, Drejtori i Trupit Certifikues ndërron ekzaminuesit apo vendimmarrësin. Aplikantët vendosen në kushte të barabarta, si gjatë procesit të ekzaminimit teorik dhe atij praktik dhe pavarësisht nëse janë trajnuar nga Organizmi Austrian Institute of Excellence .

Austrian Institute of Excellence ka për objektiv përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara në zhvillimin dhe përmirësimin e politikave dhe procedurave për çertifikimin. Për këtë qëllim është krijuar dhe Komiteti i Paanshmërisë, i cili garanton përfshirjen e palëve të interesuara.

### Drejtori i Austrian Institute of Excellence

**AIE – Austrian Institute of Excellence**, Rruga e Dibrës, Kompleksi Halili, 1017 Tiranë, Albania

Tel: +355 (0) 4 2 419 552 | Mobile: +355(0) 68 20 50 673, e-mail: [projects@aie.al](mailto:projects@aie.al) Web: [www.aie.al](http://www.aie.al)